



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 174

Tiranë – E martë, 29 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 102/2020, datë 29.7.2020	Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin..... 12293
Ligj nr. 111/2020, datë 29.7.2020	Për disa shtesa në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar..... 12302
Ligj nr. 113/2020, datë 29.7.2020	Për shtetësinë..... 12303
Vendim i Kuvendit nr. 51/2020, datë 24.9.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11591, datë 10.8.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 113/2020, ‘Për shtetësinë’” 12310
Vendim i Kuvendit nr. 52/2020, datë 24.9.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11590, datë 10.8.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 111/2020, ‘Për disa shtesa në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, ‘Për pronat e paluajtshme të shtetit’, të ndryshuar” 12310
Vendim i Kuvendit nr. 53/2020, datë 24.9.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11589, datë 10.8.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 102/2020, ‘Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin’” 12310
Rezolutë e Kuvendit datë 24.9.2020	Për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe planin e masave për përmbushjen e përparësive të përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian..... 12310
Dekret i Presidentit nr. 11743, datë 24.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12312
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 515, datë 18.9.2020	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, ‘Për përfitimet nga statusi i të verbrit’, i ndryshuar” 12313

Urdhër i ministrit të Drejtësisë
nr. 189/1, datë 22.9.2020

Për korrigjimin e gabimeve materiale në urdhrin nr. 189, datë
22.6.2020, të ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullore për
konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e
anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësorë
Privatë”

12314



LIGJ
Nr. 102/2020

PËR ZHVILLIMIN RAJONAL
DHE KOHEZIONIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë të përgjegjësisë dhe të rregullave për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë;
- b) të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal;
- c) të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve;
- ç) të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Autoritet menaxhues” është autoriteti i ngarkuar me ligj për zbatimin e programit operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

2. “Dokumentet e programimit” janë dokumente shumëvjeçare zbatimi, të mbështetura me buxhetin përkatës, të hartuara në nivel kombëtar dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

3. “Instrumentet” janë instrumente politike që lidhen me vendimmarrjen dhe instrumente financiare, të cilat mbështesin financiarisht të parat.

4. “Kohezion” është ndërveprimi dhe përafrimi i nivelit ekonomik, social, kulturor e mjedisor mes dhe brenda rajoneve të ndryshme të zhvillimit, eliminimi i pabarazimeve ndërmjet tyre.

5. “Zhvillimi rajonal dhe kohezioni” është procesi që inkurajon rajonet më pak të zhvilluara për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, nëpërmjet shfrytëzimit të potencialeve të rajoneve për sa i përket kapitalit fizik dhe atij human.

6. “Politika kombëtare për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, në vijim politika rajonale, është dokumenti që përcakton kuadrin referues të detyrueshëm për të gjitha dokumentet e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe kohezionit, si dhe për instrumentet përkatëse të financimit.

7. “Rajoni zhvillimor” është një territor ndërmjet nivelit kombëtar dhe vendor, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, historike, kulturore, mjedisore, institucionale dhe politike, që e identifikojnë atë edhe fizikisht.

8. “Territori” është çdo vend apo hapësirë gjeografike, sociale dhe ekonomike brenda kufijve kombëtarë të Republikës së Shqipërisë.

9. “Përfituesit” janë subjekte që përfitojnë mbështetje dhe grante në kuadër të masave dhe/ose thirrjeve që organizohen në përputhje me përcaktimet e programit operacional.

10. “Organi i ndërmjetëm” është çdo organ publik që ngarkohet të kryejë funksione të deleguara nga autoriteti menaxhues për zbatimin e programit operacional të miratuar sipas këtij ligji.

11. “Marrëveshja e delegimit” është marrëveshja e lidhur ndërmjet autoritetit menaxhues dhe një organi të ndërmjetëm, sipas këtij ligji.

12. “Ndërrhyrje e integruar në territor (NIT)” është një prej instrumenteve të programit operacional, e cila synon një qasje që mundëson



integrimin e objektivave të ndryshëm të programit operacional në një territor të caktuar me karakteristika specifike dhe që është i ndryshëm nga rajoni zhvillimor.

KREU II

ZHVILLIMI RAJONAL DHE KOHEZIONI

Neni 4

Rajonet e zhvillimit

1. Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër rajone zhvillimi.

2. Rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal. Rajonet e zhvillimit nuk janë njësi administrative në kuptim të legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

3. Rajonet e zhvillimit përcaktohen si njësi territoriale, që përfshijnë disa njësi të vetëqeverisjes vendore duke konsideruar:

- a) vendndodhjen dhe pozicionin gjeografik të tyre;
- b) karakteristikat e zhvillimit socio-ekonomik;
- c) numrin e popullsisë;
- ç) perspektivën e zhvillimit ekonomik.

4. Rajonet e zhvillimit dhe kufijtë e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke konsideruar elementet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 5

Synimet kryesore të zhvillimit rajonal

Synimet e zhvillimit rajonal, sipas përcaktimit të këtij ligji, janë:

a) zhvillimi i qëndrueshëm, i ekuilibruar shoqëror dhe ekonomik, si dhe kohezioni territorial në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) reduktimi i pabarazive ndërmjet dhe brenda rajoneve të zhvillimit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët;

c) rritja e konkurrueshmërisë së rajoneve të zhvillimit përmes forcimit të kapaciteteve të tyre inovative, përdorimit maksimal dhe vlerësimit të burimeve natyrore, burimeve njerëzore dhe veçorive ekonomike;

ç) ruajtja dhe forcimi i identitetit specifik të rajonit të zhvillimit;

d) mbështetja e bashkëpunimit ndërvendor, ndërrajonal dhe ndërkufitar të njërive të vetëqeverisjes vendore për zhvillimin social dhe ekonomik të rajoneve të zhvillimit.

Neni 6

Parimet për zhvillimin rajonal

Zhvillimi rajonal në Republikën e Shqipërisë zbatohet në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) parimi i partneritetit për politikën rajonale. Ky parim nënkupton pjesëmarrjen, bashkëvendimmarrjen dhe bashkëpërgjegjësinë e enteve publike dhe jopublike, që bashkëpunojnë për të përcaktuar prioritetet e politikës rajonale dhe kontribuojnë në zbatimin e politikës, në arritjen e objektivave specifike, si dhe në monitorimin e vlerësimin e saj;

b) parimi i subsidiaritetit. Ky parim nënkupton delegimin e proceseve të planifikimit dhe zbatimit të politikës rajonale në nivelin qeverisës dhe/ose administrativ më të ulët të mundshëm, që njëkohësisht garanton efikasitetin më të lartë për procesin respektiv;

c) parimi i qëndrueshmërisë. Ky parim nënkupton angazhimin e plotë të politikës rajonale për realizimin e objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë;

ç) parimi i planifikimit. Planifikimi i zhvillimit rajonal duhet të bëhet nëpërmjet dokumenteve për planifikimin e zhvillimit, si kusht paraprak për përgatitjen e ndërhyrjeve dhe shpërndarjen e fondeve për zhvillimin rajonal;

d) parimi i programimit. Ky parim nënkupton se qëndrueshmëria e objektivave dhe planifikimi financiar i politikës rajonale do të sigurohet në bazë të një sistemi programimi shumëvjeçar dhe në të gjitha nivelet;

dh) parimi i transparencës. Ky parim nënkupton që proceset e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe ato të vendimmarrjes për përdorimin e burimeve do të jenë publike. Komuniteti do të informohet për disponueshmërinë e burimeve dhe rezultatet e arritura;

e) parimi i përqendrimit. Ky parim nënkupton se shpërndarja e fondeve dhe përdorimi i burimeve të tjera financiare publike në territor do të bëhet në përputhje me objektivat dhe prioritetet që përcakton politika rajonale, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm e të ekuilibruar shoqëror dhe ekonomik, si dhe kohezionin territorial;



ë) parimi i bashkërendimit. Ky parim nënkupton harmonizimin e politikës rajonale me politikat e tjera publike, të cilat kanë ndikim në rajon, si dhe përfshirjen aktive në proceset e hartimit e të zbatimit të kësaj politike të të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetet zhvillimore, veçanërisht të autoriteteve vendore.

Neni 7

Subjektet përgjegjëse në zhvillimin rajonal

1. Bazuar në parimin e partneritetit dhe të përgjegjësive që përcakton ky ligj, subjektet përgjegjëse në zbatimin e politikës për zhvillimin rajonal janë si më poshtë:

- a) organet e qeverisjes në nivel qendror;
- b) organet e vetëqeverisjes vendore;
- c) shoqëria civile;
- ç) sektori privat;
- d) institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore.

2. Subjektet përgjegjëse, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përfshihen në proceset e koordinimit, të konsultimit, të negociimit dhe të bashkëpunimit, në mënyrë që të mundësohet dakordësia e tyre për drejtimit strategjike të zhvillimit, duke siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe përfshirje të aktorëve në arritjen e objektivave të politikës rajonale.

Neni 8

Politika e zhvillimit rajonal dhe e kohezionit

1. Politika e zhvillimit rajonal dhe kohezionit përcakton drejtimit për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik në të gjitha pjesët e territorit të Republikës së Shqipërisë për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë.

2. Politika e zhvillimit rajonal dhe kohezionit hartohet nga Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të zëvendëskryeministrit.

KREU III

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT DHE TË PROGRAMIMIT PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Neni 9

Baza e të dhënave për zhvillimin rajonal

1. Në funksion të zbatimit të politikës për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, autoriteti menaxhues ngre një bazë të dhënash rajonale në nivelin kombëtar, të cilat kanë karakter socio-ekonomik dhe territorial. Baza e të dhënave, ndërmjet të tjerave, përfshin edhe regjistrin e zhvillimit rajonal, që përmban të gjitha masat dhe stimujt për zhvillimin rajonal, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Hartimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Për të ngritur dhe mbajtur bazën e të dhënave, autoriteti menaxhues ka të drejtë të përdorë edhe baza të tjera të dhënash, të cilat mbahen nga ente shtetërore të autorizuar, institucione, agjenci publike, koncesionarë dhe autoritete të tjera të autorizuar. Administruesit e këtyre bazave të të dhënave, të hartave dhe fotove ortodixhitale janë të detyruar të vënë në dispozicion, pa pagesë, çdo informacion që i shërben krijimit të bazës së të dhënave nga autoriteti përkatës.

3. Kushtet dhe procedurat e ngritjes së bazës së të dhënave, autoritetet përgjegjëse që do të përfshihen dhe do të bashkëpunojnë në procesin e ngritjes së bazës së të dhënave dhe kategoritë e të dhënave që duhet të përfshihen përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Baza e të dhënave, që do të krijohet në përputhje me përcaktimin e bërë në këtë ligj, financohet nga buxheti i shtetit dhe/ose burime të tjera financimi nga donatorë të ndryshëm.

4. Baza e të dhënave të zhvillimit rajonal siguron akses përdorimi falas nga të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin rajonal, institucionet publike e private dhe publiku i gjerë.

Neni 10

Dokumentet për planifikimin dhe programimin e zhvillimit rajonal

Politika rajonale zbatohet nëpërmjet dokumenteve të mëposhtme të planifikimit dhe të



zhvillimit, të koordinuara ndërmjet njësisve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore:

- a) Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;
- b) planet rajonale të zhvillimit rajonal dhe kohezionit;
- c) programi operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

Neni 11

Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

1. Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është dokumenti kombëtar që orienton zbatimin e politikës për zhvillimin rajonal dhe investimet përkatëse nëpërmjet vendosjes së objektivave dhe parimeve të përbashkëta në nivel kombëtar.

2. Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin përcakton drejtimit strategjike të zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit në nivel kombëtar dhe rajonal, prioritetet e zhvillimit të lidhur me të dhe që ndikojnë në përmbushjen e objektivave të politikës rajonale.

3. Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është mjeti i planifikimit të drejtimeve prioritare të zhvillimit rajonal, të zbatimit, të monitorimit dhe të vlerësimit të produkteve/projekteve afatshkurtra dhe afatmesme, si dhe financimin, në mënyrë që të krijojë zona zhvillimi sociale, ekonomike dhe territoriale, duke u bazuar në politikën kombëtare të zhvillimit rajonal.

4. Plani Kombëtar për Zhvillim Rajonal dhe Kohezionin përmban vizionin, parimet, objektivat strategjike, prioritetet dhe drejtimit e zhvillimit rajonal, fushat tematike dhe potencialet rajonale, ndikimin hapësinor të synuar të politikës rajonale, sistemin e zbatimit për programet e zhvillimit rajonal, mekanizmin financiar e instrumentet dhe sistemin e tij të monitorimit e të vlerësimit.

5. Plani Kombëtar për Zhvillim Rajonal dhe Kohezionin hartohet bazuar edhe në përputhje me dokumentet e tjera politike në nivel kombëtar e lokal.

6. Dokumentet kryesore, që shërbejnë si bazë për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zhvillimin

Rajonal dhe Kohezionin, janë si më poshtë:

- a) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- b) Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit;
- c) planet e përgjithshme vendore;
- ç) planet rajonale të zhvillimit rajonal.

7. Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin hartohet për një periudhë zbatimi 7-vjeçare nga Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të zëvendëskryeministrit.

8. Procedurat për hartimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Planet rajonale të zhvillimit rajonal

1. Planet rajonale të zhvillimit rajonal janë dokumente strategjike rajonale, që kanë për qëllim të përcaktojnë drejtimit e zhvillimit të rajoneve zhvillimore, në mënyrë që të garantohet zhvillimi rajonal dhe kohezioni, sipas vizionit të përcaktuar nga Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

2. Planet rajonale të zhvillimit rajonal hartohen dhe zbatohen për çdo rajon zhvillimi në përputhje dhe në koordinim me dokumentet e planifikimit në nivel kombëtar e vendor.

3. Planet rajonale të zhvillimit rajonal duhet të përmbajnë të paktën një analizë të detajuar socio-ekonomike dhe territoriale të rajonit, një strategji dhe prioritetet për zhvillimin e rajonit, ndërhyrjet dhe masat e mundshme për zbatimin e strategjisë në rajon.

4. Planet rajonale të zhvillimit rajonal hartohen për një periudhë zbatimi 7-vjeçare nga bordet rajonale të monitorimit dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të zëvendëskryeministrit.

5. Procedurat për hartimin e planeve rajonale të zhvillimit rajonal miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Programi operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin

1. Programi operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin është dokumenti i programimit të



zhvillimit në nivel kombëtar, që përcakton specifikimet për zbatimin e politikës rajonale.

2. Programi operacional është instrumenti i planifikimit dhe i programimit të prioriteteve e drejtimeve të zhvillimit rajonal dhe përfshin instrumentet financiare dhe mjetet e financimit, zbatimin dhe monitorimin, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të rajoneve të zhvillimit, bazuar në Planin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

3. Programi operacional duhet të jetë i koordinuar dhe në përputhje me dokumentet e tjera të planifikimit, të përcaktuara në pikën 6 të nenit 11 të këtij ligji.

4. Programi operacional përmban të paktën çështjet si më poshtë:

a) strategjinë dhe objektivat e investimeve;
b) përshkrimin e drejtimeve prioritare;
c) përshkrimin e shembujve e të llojeve të veprimeve që mund të mbështeten dhe kontributin e tyre në objektivat e programit, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, identifikimin e grupeve kryesore të synuara, territoret specifike të synuara dhe llojet e përfituesve;

ç) treguesit e produkteve (*output*) dhe të rezultateve sipas drejtimeve prioritare;

d) koherencën me politikat kombëtare (dhe politikat e komunitetit);

dh) planin e financimit;

e) marrëveshjet për zbatimin:

i. autoritetet dhe entet përgjegjëse për zbatimin;

ii. sistemet e menaxhimit, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit;

iii. sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit.

ë) çështjet horizontale:

i. zhvillimi i qëndrueshëm;

ii. mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi.

5. Programi operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin mund të parashikojë edhe ndërhyrje të integruara në territor, bazuar në nevojat specifike të këtij territori, që është i ndryshëm nga rajoni zhvillimor. Shtrirja gjeografike e ndërhyrjeve do të përcaktohet sipas nevojave specifike, që identifikohen në programin operacional.

6. Zbatimi i programit operacional dhe arritja e objektivave dhe e treguesve të përcaktuar aty do të rishikohen një herë në vit, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 23 të këtij ligji.

7. Programi operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin hartohet për një periudhë zbatimi 7-vjeçare nga Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të zëvendëskryeministrit.

8. Procedurat për hartimin e programit operacional për zhvillimin rajonal miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Përputhshmëria e dokumenteve të planifikimit dhe të programimit

Politika rajonale zbatohet në përputhje me dokumentet e planifikimit, të hartuara dhe të koordinuara ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore si më poshtë:

a) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI);

b) Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit;

c) Politika Kombëtare për Zhvillimin Rajonal;

ç) Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;

d) strategjitë kombëtare sektoriale dhe planet kombëtare sektoriale;

dh) planet rajonale për zhvillimin rajonal;

e) planet e përgjithshme vendore.

Neni 15

Financimi i zhvillimit rajonal

1. Fondi për zhvillimin rajonal është mekanizimi për financimin e programit operacional dhe krijohet kryesisht nga kontributi i buxhetit të shtetit. Fondi mund të përfshijë çdo burim tjetër financiar nga sektori publik dhe privat në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë programet e asistencës së donatorëve të ndryshëm.

2. Fondi për zhvillimin rajonal financon programet dhe projektet për zhvillimin rajonal të përfshira në dokumentin e programit operacional për zhvillimin rajonal dhe kohezionin. Fondi përfshin shumat e alokuara çdo vit nga buxheti i shtetit, si një zë i veçantë buxhetor, si dhe shumat e siguruar nga burime të tjera, në funksion të zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit.



3. Fondi alokohet në funksion të zbatimit të programit operacional, në përputhje me parashikimet e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm, dhe menaxhohet nga autoriteti menaxhues, me miratimin paraprak të Komitetit Kombëtar të Zhvillimit Rajonal.

4. Fondi për zhvillimin rajonal përdoret për qëllimet dhe aktivitetet e mëposhtme:

a) zbatimi i projekteve të zhvillimit rajonal, të cilat konsiderohen të një rëndësie kombëtare, rajonale apo vendore, në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) përmirësimi i sektorëve të industrisë, niveli i teknologjisë, qasja në teknologji të reja, promovimi i kërkimit dhe zhvillimit;

c) përmirësimi i konkurrencës rajonale;

ç) zhvillimi i qyteteve dhe i fshatrave;

d) përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit;

dh) zhvillimi i turizmit dhe i zonave të mbrojtura mjedisore;

e) zhvillimi i zonave të pazhvilluara;

ë) zhvillimi i shoqërive, që ushtrojnë aktivitet ekonomik, dhe përmirësimi i kushteve për promovimin e punësimit;

f) përmirësimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;

g) përmirësimi i infrastrukturës në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;

gj) përmirësimi i bashkëpunimit ndërvendor, ndërrajonal, ndërkombëtar dhe ndërkufitar për çështjet me interes të përbashkët;

h) përmirësimi i të gjitha aftësive zhvillimore në nivel rajonal dhe lokal;

i) menaxhimi dhe administrimi i zbatimit të programit operacional për zhvillimin rajonal;

j) përmirësimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

k) zhvillimi social, kulturor, artistik dhe i industrisë krijuese;

l) qëllime të tjera në përputhje me këtë ligj.

5. Përfitues të aktiviteteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni janë subjektet si më poshtë:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) subjektet ekonomike në nivel rajonal dhe lokal;

c) institucionet dhe organizatat në nivel kombëtar, rajonal e lokal;

ç) institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore;

d) shoqatat;

dh) shoqëritë tregtare.

6. Përfituesit potencialë të këtyre aktiviteteve përcaktohen nga programi operacional, bazuar në drejtimet prioritare dhe masat e parashikuara në të. Kur është rasti, programi operacional njoftohet për të marrë autorizimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

7. Kushtet dhe procedurat e detajuara për përdorimin e burimeve financiare të fondit për zhvillimin rajonal përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Përdorimi dhe zbatimi i fondit për zhvillimin rajonal, që financon programin operacional, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon kontrollin dhe menaxhimin financiar.

Neni 16

Bashkëfinancimi dhe bashkimi i fondeve

1. Programi operacional, masat dhe projektet mund të bashkëfinancohen nga burime të ndryshme financimi, me kontribut në para ose në natyrë, duke bërë përqendrimin e fondeve e të kontributeve.

2. Rastet e bashkëfinancimit, vlerat dhe rregullat e detajuara për bashkëfinancimin e masave/projekteve të përzgjedhura përcaktohen në programin operacional.

3. Fondet e përqendruara nën programin operacional mund të ekzekutohen nga një autoritet kontraktues i vetëm, duke bërë bashkimin e fondeve ose nga disa autoritete kontraktuese, në mënyrë të veçantë nga njëri-tjetri, sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit dhe/ose financimit.

KREU IV

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Neni 17

Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

1. Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin krijohet nga Këshilli i Ministrave dhe është organi përgjegjës për zhvillimin, hartimin dhe zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal, si dhe për koordinimin e zbatimit të masave për zhvillimin rajonal.

2. Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal është autoriteti programues dhe monitorues,



përgjegjës për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e programit operacional, siç përcaktohet në nenin 23 të këtij ligji.

3. Komiteti Kombëtar i Zhvillimit Rajonal ushtron këto kompetenca:

a) harton dhe miraton paraprakisht politikën e zhvillimit rajonal dhe të kohezionit;

b) harton dhe miraton paraprakisht programin operacional për zhvillimin rajonal dhe ndryshimet e tij të mëposhme;

c) miraton metodologjinë dhe kriteret që do të përdoren në përzgjedhjen e projekteve të zhvillimit, si dhe projekteve specifike me rëndësi rajonale, të përcaktuara si projekte prioritare zhvillimi, që do të financohen në kuadër të programit operacional;

ç) miraton raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit dhe vlerëson programin operacional sipas rastit;

d) i ngarkon detyra autoritetit menaxhues sipas rastit;

dh) harton dhe miraton paraprakisht Planin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal;

e) miraton paraprakisht planet përkatëse të zhvillimit rajonal.

4. Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është një organ ndërinstitucional dhe drejtohet nga zëvendëskryeministri. Përbërja, organizimi, veprimtaria dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Fondi Shqiptar i Zhvillimit siguron mbështetje teknike dhe kryen rolin e sekretariatit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin për hartimin e dokumenteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, si dhe për të gjitha çështjet lidhur me zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

Neni 18

Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal

1. Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal janë organet kryesore që promovojnë interesat e rajoneve të zhvillimit dhe veprojnë si një organ i përbashkët i njësive të vetëqeverisjes vendore të rajonit të zhvillimit. Bordet bashkëpunojnë me autoritetet e pushtetit qendror dhe aktorët e tjerë të përfshirë në planifikimin, programimin dhe zbatimin e politikës rajonale, në përputhje me parimin e partneritetit.

2. Në përcaktimin e përbërjes së bordeve zbatohet parimi i partneritetit, duke siguruar praninë e njësive të vetëqeverisjes vendore, të sektorit privat, të institucioneve kërkimore-shkencore, të shoqërisë civile dhe medias.

3. Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal janë përgjegjëse për hartimin dhe dakordësimin përpara përcjelljes për miratim të planeve të zhvillimit rajonal dhe bashkëpunojnë në përgatitjen e programit operacional për zhvillimin rajonal.

4. Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal krijohen me vendim të organeve përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore. Përbërja, organizimi, veprimtaria dhe procedurat e krijimit e të funksionimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nëpërmjet strukturave të veta përkatëse në rajonet e zhvillimit, siguron mbështetje teknike për hartimin e dokumenteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, si dhe kryen rolin e sekretariatit të bordeve të monitorimit të zhvillimit rajonal.

Neni 19

Autoriteti menaxhues

1. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ushtron funksionet e autoritetit menaxhues të programit operacional në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e përcaktuara në programin operacional për zbatimin e masave/projekteve, që synojnë promovimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror, ekonomik dhe kohezionin territorial.

2. Autoriteti menaxhues është përgjegjës për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe për arritjen e objektivave dhe treguesve të matshëm të tij.

3. Funksionet kryesore të autoritetit menaxhues janë si më poshtë:

a) të mbështesë punën e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, si dhe t'i sigurojë informacionin që ai kërkon për të kryer detyrat e tij, veçanërisht të dhënat që lidhen me përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të programit operacional në arritjen e objektivave të tij, të dhënat financiare dhe të indikatorëve të tij;

b) të koordinojë dhe të kontribuojë në përgatitjen e politikës së zhvillimit rajonal dhe



kohezionit të Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionit dhe të planeve rajonale të zhvillimit rajonal;

c) të koordinojë përgatitjen dhe të menaxhojë zbatimin e programit operacional për zhvillimin rajonal, të zbatojë masat përkatëse të tij, si dhe të përcaktojë kriteret e veçanta të përzgjedhjes në thirrjet për projekte;

ç) të përgatisë projekte, studime fizibiliteti, analiza në funksion të zbatimit të programit operacional për zhvillimin rajonal;

d) të koordinojë punën e strukturave rajonale të zhvillimit, të përgatisë dhe të zbatojë masa që ofrojnë ndihmë për ndërtimin e kapaciteteve për të menaxhuar fondet dhe politikën e kohezionit të Bashkimit Europian dhe të partnerëve të tjerë të zhvillimit, të ofrojë shërbime këshillimi dhe të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve për përgatitje projektesh, menaxhimin e tyre nga strukturat rajonale të zhvillimit dhe aktorët e tjerë të zhvillimit;

dh) të kryejë, sipas rastit, menaxhimin dhe/ose zbatimin e programeve të përbashkëta rajonale, ndërrajonale dhe ndërkuftare (me më shumë se një përfitues), nëse ka një marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti për këtë qëllim, me partnerët e zhvillimit dhe financuesit në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;

e) të krijojë dhe të përditësojë bazën e të dhënave të zhvillimit rajonal në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij ligji. Hartimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Autoriteti menaxhues mund të delegojë një pjesë të funksioneve dhe të detyrave të tij te një ose më shumë organe të ndërmjetme, të caktuara përmes një akti delegimi. Delegimi i funksioneve dhe i detyrave, gjithashtu, siguron fondet e nevojshme për organet e ndërmjetme që të kryejnë funksionet e deleguara. Çdo delegim funksionesh dhe detyrash bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti menaxhues do të mbetet përgjegjës për të gjitha funksionet e deleguara përpara Komitetit Kombëtar të Zhvillimit Rajonal.

5. Në rast të delegimit të një pjese të funksioneve të tij, siç përcaktohet në pikën 4 të këtij neni, autoriteti menaxhues mbikëqyr zbatimin e funksioneve të deleguara tek organet e ndërmjetme.

6. Kostot operacionale për menaxhimin dhe zbatimin e programit operacional, përcaktohen në programin operacional në masën 7% të buxhetit të përgjithshëm të tij. Këto kosto operacionale mbulojnë edhe kostot e organeve të ndërmjetme, në rast se përfshihen në zbatimin e funksioneve të caktuara.

7. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e autoritetit menaxhues, duke përfshirë edhe funksionet zbatuese dhe mbikëqyrëse, si dhe rregullat e përgjithshme për sistemin e menaxhimit e të kontrollit të programit operacional të zhvillimit rajonal, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Organet e ndërmjetme

1. Autoriteti menaxhues i programit operacional të zhvillimit rajonal mund të caktojë një apo disa struktura me personalitet juridik publik në funksionin e organit të ndërmjetëm për zbatimin e funksioneve të caktuara të tij në zbatimin e programit operacional të zhvillimit rajonal.

2. Marrëdhënia ndërmjet autoritetit menaxhues dhe organit të ndërmjetëm, të caktuar sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohet sipas legjislacionit në fuqi dhe formalizohet me një marrëveshje delegimi, siç përcaktohet në nenin 21 të këtij ligji.

3. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e organit të ndërmjetëm, kriteret që duhet të plotësojnë, mënyra e përzgjedhjes nga autoriteti menaxhues, si dhe sistemet përkatëse të menaxhimit dhe të kontrollit për zbatimin e funksioneve të deleguara të programit operacional miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Marrëveshja e delegimit

1. Kushtet dhe formati tip i marrëveshjes së delegimit miratohen nga Komiteti Kombëtar i Zhvillimit Rajonal dhe në çdo rast ajo përmban të paktën:

a) përshkrimin e funksioneve e të detyrave të deleguara;

b) strukturën e organizimit, e nevojshme për të kryer funksionet dhe detyrat e deleguara;

c) kriteret për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemit, që do të mundësojë kryerjen e



funksioneve të deleguara, përfshirë mjetet për verifikimin e burimeve njerëzore dhe të kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e tyre;

ç) procedurat e monitorimit e të raportimit për funksionet dhe detyrat e deleguara;

d) procedurat për menaxhimin e riskut dhe korrigjimin në rastet kur organi i ndërmjetëm ka dështuar në kryerjen e këtyre funksioneve dhe të detyrave të deleguara sipas këtij ligji dhe marrëveshjes së delegimit;

dh) masat që merren në mënyrë që të parandalohet, identifikohet, menaxhohet dhe korrigjohet parregullsia e një veprimi të caktuar të organit të ndërmjetëm, si dhe masat që merren për të garantuar rikuperimin e fondeve të shpenzuara në mënyrë të parregullt.

2. Organi i ndërmjetëm nënshkruan një marrëveshje delegimi, sipas përcaktimit të këtij ligji, vetëm pasi të jetë provuar përputhja me kriteret e delegimit, përfshirë shmangien e konfliktit të interesit, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 22

Përfituesit e granteve nga fondi i zhvillimit rajonal

1. Përfituesit e granteve nga fondi i zhvillimit rajonal duhet t'u përkasin kategorive të mëposhtme:

- a) autoritetit publik vendor;
- b) autoritetit publik rajonal;
- c) autoritetit publik kombëtar;

ç) agjencisë publike (agjenci vendore, rajonale e kombëtare të zhvillimit, agjenci mjedisore, agjenci për mbrojtjen e natyrës, agjenci energjetike, agjenci punësimi, agjenci/institucione të artit, të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore etj.);

d) ofruesit publik të shërbimit të infrastrukturës (transporti publik, shoqëria e shërbimeve (furnizimi me ujë, furnizimi me energji elektrike, trajtimin të ujërave të zeza, gazi, grumbullimi dhe përpunimi i mbeturinave etj.), aeroporti, porti, hekurudha etj.);

dh) grupeve të interesit, përfshirë OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, sindikatat, fondacionet, shoqatat e vullnetarëve, klubet etj.;

e) institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore-shkencore, përfshirë fakultetin universitar, kolegjin, institucionin kërkimor etj.;

ë) institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, qendrat përgjegjëse për shërbimet arsimore, qendrat trajnuese, institucionet e arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit e të formimit profesional;

f) shoqërive tregtare;

g) organizatave për mbështetjen e biznesit (dhoma e tregtisë, dhoma e tregtisë dhe artizanatit, qendra të inovacionit, grupimet e biznesit etj.).

2. Përfituesit e granteve nga fondi i zhvillimit rajonal, në kuadër të masave dhe/ose thirrjeve që organizohen në përputhje me përcaktimet e programit operacional, janë përgjegjës për zbatimin e projektit për të cilin kanë përfitur grantin, në përputhje me parashikimet e kontratës të nënshkruar me autoritetin menaxhues.

3. Përfituesit kanë përgjegjësinë për të garantuar zbatimin e projekteve/operacioneve, të sigurojnë që shpenzimet janë kryer në funksion të zbatimit të projektit, në përputhje me aktivitetet dhe planin e projektit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar me autoritetin menaxhues.

4. Përveç detyrimeve të tjera të përcaktuara në kontratë, përfituesi duhet:

a) të përgatisë raporte financiare, të ruajë dhe të vendosë në dispozicion të gjithë dokumentacionin shoqërues për të verifikuar shpenzimet për secilën prej periudhave të raportimit, të përcaktuara për projektin;

b) të mbajë përgjegjësi për çdo parregullsi në shpenzimet e raportuara;

c) të ndërmarrë aktivitete për informimin dhe komunikimin në përputhje me kërkesat përkatëse të programit për komunikimin;

ç) të sigurojë qëndrueshmërinë e produkteve kryesore dhe të rezultateve të projektit.

5. Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes së përfituesve do të përcaktohen në programin operacional për zhvillimin rajonal, ndërsa kriteret specifike të përzgjedhjes së përfituesve përcaktohen në thirrjet përkatëse për propozime.

Neni 23

Monitorimi dhe vlerësimi

1. Komiteti Kombëtar i Zhvillimit Rajonal, siç përcaktohet në nenin 17 të këtij ligji, kryen funksionet e monitorimit për zbatimin e politikës rajonale dhe programit operacional për zhvillimin rajonal.



2. Komiteti Kombëtar i Zhvillimit Rajonal miraton rregullat dhe procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e politikës rajonale dhe programit operacional për zhvillimin rajonal.

3. Një herë në vit, Komiteti Kombëtar i Zhvillimit Rajonal rishikon zbatimin e programit operacional për zhvillimin rajonal dhe përmbushjen e objektivave e të synimeve të përcaktuara në të, bazuar në raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit të përgatitura nga autoriteti menaxhues.

4. Bazuar në parimin e përqendrimit dhe të partneritetit, bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal, siç përcaktohen në nenin 18 të këtij ligji, monitorojnë zbatimin e planeve rajonale të zhvillimit rajonal.

5. Bordet rajonale të monitorimit ushtrojnë këto funksione në kuadër të monitorimit:

a) mbikëqyrin dhe monitorojnë zbatimin e planit të zhvillimit rajonal për rajonin përkatës të zhvillimit;

b) japin mendime për programin operacional për rajonin përkatës të zhvillimit;

c) kontribuojnë në monitorimin e programit operacional për rajonin përkatës të zhvillimit;

ç) dorëzojnë raporte vjetore për punën e tyre në Komitetin Kombëtar të Zhvillimit Rajonal.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Dispozitat kalimtare

1. Programet dhe projektet e investimeve, që zbatohen aktualisht në Republikën e Shqipërisë dhe që janë të financuara si nënprograme të zhvillimit rajonal, integrohen plotësisht në programin operacional në përputhje me parashikimet sipas marrëveshjeve të financimit të nënshkuara.

2. Agjencitë përgjegjëse, që kryejnë funksione zbatimi në drejtim të zhvillimit rajonal, do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e ngarkuara deri në krijimin dhe funksionimin e plotë të Komitetit e të bordeve dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit e të programimit të zhvillimit rajonal, siç përcaktohet në këtë ligj.

Neni 25

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pika 4; 8, pika 2; 11, pika 8; 12, pika 5; 13, pika 8; 17, pika 4; dhe 18, pika 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 7; 12, pika 4; 19, pika 7; dhe 20, pika 3, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 (nëntë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 3; 13, pika 7; dhe 15, pika 7, të këtij ligji.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 111/2020

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8743,
DATË 22.2.2001, “PËR PRONAT E
PALUAJTSHME TË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 41, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:



Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) “bregu i detit” është sipërfaqja e tokës përgjatë detit, me gjerësi dhe kufi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, e cila është pronë publike e patjetërsueshme.”.

Neni 2

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 3 pas fjalëve “vija bregdetare për të hyrë në tokë” shtohen fjalët “bregu i detit”.

Neni 3

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Pronat e shtetit në përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore, që u kalojnë me destinacion palëve të treta

Pronat e paluajtshme të shtetit, të cilat u kanë kaluar në përgjegjësi administrimi institucioneve qendrore, sipas dispozitave të këtij ligji, për t’u vendosur në dispozicion të subjekteve të së drejtës private, që synojnë realizimin e një interesi publik pa qëllim fitimi, të themeluara dhe që funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, përdoren për aq kohë sa subjekti privat jofitimprurës ekziston, destinacioni i përdorimit dhe zhvillimit të pronës nuk ndryshon dhe kur në pronë është kryer investim mbi 5 milionë euro për qëllimet e aktivitetit të tij.

Rregullat dhe procedurat për lidhjen e kontratës së përdorimit pa afat, sipas kriterëve të mësipërme, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në çdo rast, në kontratën e përdorimit do të specifikohet se pronës nuk mund t’i ndryshohet destinacioni.

Në asnjë rast kjo pronë, së bashku me ndërtime, investimet dhe përmirësimet e saj, nuk mund të jetë objekt i asnjë barre hipotekore apo procedure ligjore nga kreditorët e subjektit juridik privat jofitimprurës, për të realizuar

vjeljen e detyrimeve që këta kreditorë kanë ndaj personit juridik privat jofitimprurës.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 29.7.2020.

LIGJ

Nr. 113/2020

PËR SHTETËSINË

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “b”, e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, procedurave dhe rregullave për fitimin, rifitimin e humbjen e shtetësisë shqiptare.

**Neni 2
Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Fëmijë” është i njëjti kuptim sipas përkufizimit të bërë në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

b) “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

c) “Ministria” është ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

ç) “Natyralizim” është mënyra e fitimit të shtetësisë shqiptare nga çdo person i huaj apo pa



shtetësi, që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe shpreh dëshirën për të qenë shtetas shqiptar.

d) “Origjinë” është lidhja familjare në vijë të drejtë deri në tri shkallë e kërkuarit me të paralindurin me shtetësi shqiptare.

dh) “Person pa shtetësi” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 9057, datë 24.04.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Statusin e Personave pa Shtetësi”.

e) “Refugjat dhe person në mbrojtje plotësuese” është i njëjti kuptim sipas përkufizimit në ligjin për azilin në Republikën e Shqipërisë.

ë) “Shtetësi shqiptarë” është lidhja e qëndrueshme juridike ndërmjet një personi dhe shtetit shqiptar, që shprehet në të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e ndërsjella e që nuk tregojnë origjinën etnike të personit.

Neni 3

Parimet

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare bazohet në parimet e mëposhtme:

a) të drejtën e çdo personi për të gëzuar të paktën një shtetësi;

b) shmangien e pashtetësisë;

c) askujt nuk i mohohet apo hiqet në mënyrë arbitrare shtetësia shqiptare;

ç) mosdiskriminimin e shtetasve shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë shtetas që nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

KREU II

FITIMI, RIFITIMI DHE HUMBJA E SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 4

Mënyrat e fitimit të shtetësisë

Shtetësia shqiptare fitohet me:

a) lindje;

b) origjinë;

c) lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) natyralizim;

d) birësim.

Neni 5

Fitimi i shtetësisë me lindje

Kushdo që lind, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare dhe regjistrohet si shtetas shqiptar. E drejta për t’u regjistruar si shtetas shqiptar nuk parashkruhet edhe pasi ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

Neni 6

Fitimi i shtetësisë me origjinë

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinën shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë deri në tri shkallë e kërkuarit me të paralindurin.

2. Në këtë rast shtetasi paraqet kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare në bazë të origjinës dhe plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat “dh” dhe “ë” të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.

3. Dokumentacioni i nevojshëm që provon origjinën shqiptare të kërkuarit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 7

Fitimi i shtetësisë me lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që mund të mbetet pa shtetësi fiton shtetësinë shqiptare

2. Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur ligjërisht përpara se fëmija të ketë mbushur moshën 14 (katërmëdhjetë) vjeç dhe janë shtetas të huaj, ata mund të kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare të fëmijës, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi.

Neni 8

Fitimi i shtetësisë me natyralizim

1. Shtetësia shqiptare fitohet me natyralizim nga i huaji që ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

b) ka zotësi juridike për të vepruar;

c) qëndron në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se



7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka përfituar leje të përhershme qëndrimi, të vlefshme në momentin e paraqitjes së kërkesës, sipas ligjit për të huajt;

ç) ka banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në Republikën e Shqipërisë;

d) disponon të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë, që përkojnë me standardin minimal të jetesës, të indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të parashikuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

dh) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përrjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;

e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur e të shkruar, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, si dhe njohuritë bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë;

ë) nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Në rast se personi është pa shtetësi, ai mund ta fitojë shtetësinë shqiptare nëse plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “c”, “dh” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni.

3. I huaji, që është i martuar me shtetas shqiptar për një periudhë prej jo më pak se 3 (tre) vjetësh, mund të paraqesë kërkesë për të fituar shtetësinë me natyralizim, edhe nëse nuk plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, nëse ka banuar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën për 1 (një) vit.

4. I huaji, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare, mund të paraqesë kërkesë për të fituar shtetësinë me natyralizim, edhe nëse nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni, nëse ka banuar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën për tre vjet.

5. Në rast se të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tyre, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, kur jeton me prindërit,

fiton shtetësinë shqiptare me kërkesën e prindërve dhe me pëlqimin e fëmijës kur është në moshën 14-18 (katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç.

6. Në rast se njëri prej prindërve fiton shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tij, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, fiton shtetësinë shqiptare nëse kërkohet nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve dhe fëmija ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë e, në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin. Përrjashtohen rastet kur vërtetohet pamundësia objektive e prindit tjetër për të dhënë pëlqimin.

7. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim, sipas parashikimeve të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 9

Rastet e veçanta të fitimit të shtetësisë shqiptare

1. Shtetësia shqiptare mund të fitohet nga shtetasi i huaj që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç kur nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, edhe në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit.

2. Për hartimin e programeve të veçanta, përcaktimin e rregullave specifike të kontrollit të veçantë të sigurisë dhe pastërtisë së figurës në standardet më të larta dhe monitorimin e zbatimit të tyre, krijohet një agjenci shtetërore e posaçme në varësi të ministrit. Organizimi dhe funksionimi i agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kriteret për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, procedurat e aplikimit, rregullat e kryerjes së verifikimeve dhe kontroleve të nevojshme miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit dhe ministrave përgjegjës sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

4. Parashikimet e neneve 17 dhe 18 të këtij ligji nuk zbatohen në rastet e fitimit të shtetësisë sipas këtij neni.



Neni 10

Fitimi i shtetësisë me birësim

1. Fëmija i birësuar fiton shtetësinë shqiptare nëse birësuesi ka shtetësinë shqiptare.

2. Në rast birësimi nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare të një fëmije me shtetësi tjetër ose pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. Fëmija i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi si rezultat i birësimit.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare me birësim, sipas parashikimeve të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 11

Fitimi i shtetësisë nga refugjatët apo personat në mbrojtje plotësuese

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga refugjati apo personi në mbrojtje plotësuese, që ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

b) ka zotësi juridike për të vepruar;

c) ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë nga dita e komunikimit të vendimit për dhënien e statusit nga autoriteti përgjegjës për azilin e refugjatët, sipas ligjit për azilin në Republikën e Shqipërisë;

ç) ka banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në Republikën e Shqipërisë;

d) disponon të ardhura ose burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë;

dh) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përrjashtëm nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;

e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur e të shkruar, të certifikuar nga institucioni përkatës arsimor publik, si dhe njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas

rregullave të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari në fushën përkatëse;

ë) nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare për këtë kategori përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 12

Humbja e shtetësisë

1. Shtetësia shqiptare humbet në këto raste:

a) me heqjen dorë, me kërkesë dhe kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 13 të këtij ligji;

b) me heqjen e shtetësisë, pa kërkesë të shtetasit, në rastet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 13

Heqja dorë nga shtetësia

1. Një person mund të heqë dorë nga shtetësia shqiptare kur ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

b) nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare;

c) është rezident në një shtet të huaj;

ç) ndaj tij nuk ka filluar ndjekja penale për veprat penale për të cilat, sipas legjislacionit penal shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 (pesë) vjet;

d) nuk ka detyrime ligjore ndaj institucioneve publike, personave fizikë dhe juridikë;

dh) ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare që mund të ketë ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijëve apo personave nën kujdestari, të cilët kanë shtetësinë shqiptare.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 14

Heqja dorë për fëmijën

1. Një fëmijë nuk do të gëzojë më shtetësinë shqiptare kur të paktën njëri nga prindërit ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe është dhënë pëlqimi i të dy prindërve.



2. Fëmija nuk e gëzon më shtetësinë shqiptare kur birësohet nga prindër të huaj dhe fiton shtetësinë e tyre.

3. Nëse prindërit janë të divorcuar, kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, duke marrë pëlqimin e prindit tjetër. Pëlqimi i prindit tjetër nuk do të jetë i nevojshëm nëse ai nuk ka një vendbanim të regjistruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj, nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose kur i është hequr përgjegjësia prindërore me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 15

Heqja e shtetësisë

1. Shtetësia shqiptare hiqet pa kërkesë në rastet si më poshtë:

a) kur vërtetohet se shtetasi ka paraqitur dokumente të falsifikuara për fitimin e shtetësisë;

b) kur shtetasi përkrah, kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë.

2. Në rastin e heqjes së shtetësisë, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, shtetësia hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese dhe brenda një afati 10-vjeçar nga bërja e betimit.

3. Në rastin e heqjes së shtetësisë, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, shtetësia hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese apo kur shtetasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vetëm për shtetasit që e kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim dhe nëse personi nuk rrezikon të mbetet pa shtetësi.

4. Shtetësia shqiptare sipas këtij neni hiqet me dekret të Presidentit të Republikës. Në këtë rast personi pushon së qenuri shtetas shqiptar në momentin e komunikimit të dekretit dhe, përjashtimisht, nëse nuk mund t'i komunikohet dekreti, pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

5. Kundër dekretit për heqjen e shtetësisë shqiptare, shtetasi ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje

me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

6. Heqja e shtetësisë shqiptare sipas këtij neni nuk ka efekt për fëmijët e shtetasit, të cilit i hiqet shtetësia.

Neni 16

Rifitimi i shtetësisë

Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe dëshiron ta rimarrë atë paraqet kërkesë për rifitimin e shtetësisë shqiptare sipas procedurës për fitimin e shtetësisë, të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, personi duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.

KREU III

PROCEDURA PËR FITIMIN, RIFITIMIN DHE HUMBJEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 17

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare paraqitet pranë strukturave vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të personit.

Rregullat e detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës sipas këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Në rast se personi banon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kërkesa për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe dokumentacioni i kërkuar sipas këtij ligji mund të paraqitet pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku ka vendbanimin.

Rregullat e detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

3. Tarifa për kërkesën për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat. Në çdo rast, tarifa nuk mund të tejkalojë koston e shërbimit.



Neni 18

Shqyrtimi i kërkesës

1. Pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 1 të nenit 17 të këtij ligji, struktura vendore e Policisë së Shtetit kryen verifikimet e nevojshme për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike dhe, brenda një afati 1-mujor nga paraqitja e kërkesës, e dërgon kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë strukturës përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të shtetësisë në ministri.

2. Pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, misioni diplomatik apo posti konsullor dërgon kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, e cila, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve i përcjell për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse në ministri.

3. Me paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ministria brenda 6 (gjashtë) muajve shqyrton dokumentacionin e paraqitur, me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për nxjerrjen e dekretit. Procedura për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse përcaktohet me udhëzim të ministrit.

4. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, ministria brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve ua kthen strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, të cilat njoftojnë personin e interesuar brenda një afati 15-ditor. Pas plotësimin të dokumentacionit zbatohet procedura sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se pas verifikimeve të kryera rezulton se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj, ministria nëpërmjet strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni njofton personin e interesuar për refuzimin e kërkesës. Refuzimi bëhet me akt administrativ të ministrit. Kundër këtij akti, personi që ka paraqitur kërkesën mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 19

Procedura e heqjes së shtetësisë

1. Ministria, pasi vihet në dijeni se një shtetas shqiptar është subjekt i rasteve të përcaktuara në

nenin 15 të këtij ligji, bashkëpunon me institucionet përgjegjëse ligjzbatuese për verifikimin e informacionit, sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të ministrit.

2. Në përfundim të kryerjes së verifikimeve, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, ministria i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për nxjerrjen e dekretit për heqjen e shtetësisë.

Neni 20

Dekreti për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë

1. Presidenti i Republikës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e propozimit nga ministria nxjerr dekretin përkatës dhe ia komunikon personit që ka paraqitur kërkesën, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk janë të plotë, i kthehen për plotësim strukturës përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të shtetësisë në Ministrinë e Brendshme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes.

2. Kopje e dekretit për fitimin, rifitimin ose lënien e shtetësisë shqiptare i dërgohet edhe Ministrisë së Brendshme për të kryer veprimet e nevojshme administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjendjen civile.

3. Dekreti botohet në Fletoren zyrtare.

4. Dekreti për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohet në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore, për administrimin e të cilit respektohen dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, formati i të cilit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 21

Betimi

Personi që fiton shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji, betohet para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Në rastet e fitimit të shtetësisë sipas nenit 9 të këtij ligji, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të



Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

Neni 22

Afati për kryerjen e betimit

1. Dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nuk do të ketë efekt nëse brenda 6 (gjashtë) muajve nga njohimi i tij personi nuk është betuar sipas nenit 21 të këtij ligji.

2. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet në rast se, për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, personi e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin. Në këtë rast personi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë ministrisë për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit, por, në çdo rast, jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Procedura dhe dokumentacioni për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

3. Kryerja e betimit bëhet sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin për gjendjen civile.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 23

Dispozitë kalimtare

1. Kërkesat për fitimin, rifitimin apo lënien e shtetësisë shqiptare, të cilat janë paraqitur pranë Ministrisë së Brendshme dhe/ose misionit diplomatik, apo postit konsullor, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen sipas ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk ka apo nuk ka fituar shtetësi tjetër, rifiton shtetësinë shqiptare mbi bazën e kërkesës së paraqitur dhe dokumentacionit shoqërues, nëse nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Në këtë rast kërkesa trajtohet sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë akt nënligjor në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 9 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë akt nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 6; të pikës 6 të nenit 8; të pikës 3 të nenit 10; të pikës 2 të nenit 11; të pikës 2 të nenit 13; të pikës 1 të nenit 17; të pikës 3 të nenit 18; të pikës 1 të nenit 19; të pikës 4 të nenit 20 dhe të pikës 2, të nenit 22, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin akt nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

4. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për financat dhe ekonominë që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin akt nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizimi

Ligji nr.8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, vendimi nr. 554, datë 3.7.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës” dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miruar në datën 29.7.2020.



**VENDIM
Nr. 51/2020**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11591,
DATË 10.8.2020, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR. 113/2020 ‘PËR SHTETËSINË’”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11591, datë 10.8.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 113/2020 ‘Për shtetësinë’”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.9.2020

**VENDIM
Nr. 52/2020**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11590,
DATË 10.8.2020 “PËR KTHIMIN
E LIGJIT NR. 111/2020, ‘PËR DISA
SHTESA NË LIGJIN NR. 8743, DATË
22.2.2001, ‘PËR PRONAT E
PALUAJTSHME TË SHTETIT’,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11590, datë 10.8.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 111/2020 ‘Për disa shtesa

në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, ‘Për pronat e paluajtshme të shtetit’, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.9.2020

**VENDIM
Nr. 53/2020**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11589,
DATË 10.8.2020, TË PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT
NR. 102/2020, ‘PËR ZHVILLIMIN
RAJONAL DHE KOHEZIONIN”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11589, datë 10.8.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr. 102/2020, ‘Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin’”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.9.2020

**REZOLUTË
PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE PËR
ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN
EVROPIAN DHE PLANIN E MASAVE
PËR PËRMBUSHJEN E PËRPARËSIVE
TË PËRCAKTUARA NGA KËSHILLI
I BASHKIMIT EVROPIAN**

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së



Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

- Duke marrë parasysh vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020, për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë bazuar në progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara me unanimitet nga Këshilli i Bashkimit Evropian;

- Duke theksuar rolin parësor të Kuvendit në kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për integrimin evropian në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integritetit dhe duke shërbyer si urë lidhëse midis aktorëve të përfshirë;

- Duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave të ndërmarra për konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke vlerësuar miratimin nga Këshilli i Bashkimit Evropian të Metodologjisë së re të Negociatave, që do t'i japë procesit më shumë dinamizëm, besueshmëri, parashikueshmëri dhe vullnet më të fortë politik;

- Duke marrë parasysh projektin e Kornizës së Negociimit me Republikën e Shqipërisë, që përcakton parimet dhe procedurat sipas të cilave do të zhvillohen negociatat e anëtarësimit, paraqitur nga Komisioni Evropian në datën 1 korrik 2020;

- Duke marrë parasysh vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian që konferenca e parë ndërqeveritare të mbahet sa më shpejt pas miratimit të Kornizës së Negociimit nga Këshilli dhe deri atëherë Shqipëria duhet të ketë miratuar reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, duke siguruar vijimësinë e rritjes së standardeve ndërkombëtare të dakordësuara dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale; të ketë siguruar vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias; të ketë përfunduar ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit

dhe krimit të organizuar; të ketë forcuar më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe përmes planveprimt për të adresuar rekomandimet e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF);

- Duke u bazuar në përparësitë që duhet të përmbajë Korniza e Negociimit, që do t'i paraqitet Shqipërisë në konferencën e parë ndërqeveritare, të përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 25 mars 2020,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Përsëritet vendimin historik të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë.

2. Vlerëson progresin e arritur në reformat që lidhen me integrimin evropian, të cilat mundësuan plotësimin e kushteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe vendimin përkatës të Këshillit të Bashkimit Evropian.

3. Rikonfirmon se procesi i negociatave dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin Evropian është objektiv madhor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kryeson agjendën e saj kombëtare, si një vend që synon dhe është i angazhuar plotësisht për konsolidimin e demokracisë, respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe minoriteteve, të dialogut politik, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë funksionale të tregut, që përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian.

4. Rikonfirmon qasjen e tij se përparimi në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian të Shqipërisë bazohet në hartimin dhe zbatimin plotësisht të reformave transformuese dhe të pakthyeshme.

5. Thekson se dialogu konstruktiv politik brenda kuadrit institucional kushtetues është thelbësor për konsolidimin e demokracisë funksionale dhe për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

6. Mori dijeni për Planin e Veprimit për plotësimin e përparësive të përcaktuara në përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të 25 marsit 2020.

7. U kërkon qeverisë dhe të gjitha institucioneve të tjera përgjegjëse që të konsolidojnë reformat e arritura dhe të thellojnë më tej reformat për plotësimin e përparësive të vendosura në



përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 mars 2020.

8. I kërkon qeverisë që të koordinojë institucionet përgjegjëse dhe ato të raportojnë në Kuvend një herë në tre muaj për zbatimin e këtij Plani Veprimi.

9. Inkurajon zyrën e Kryenegociatorit të vijojë bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim paraqitjen objektive në institucionet evropiane dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian të arritjeve dhe përparimin e reformave të realizuara.

10. Angazhohet që të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit duke forcuar më tej veprimtarinë e organeve nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si Komisioni për Integrimin Evropian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në këtë proces.

11. Angazhohet që të bashkëveprojë dhe të monitorojë me përgjegjësi të lartë të gjitha institucionet e përfshira, të cilat kanë për detyrë të marrin masat për trajtimin me përparësi të të gjitha kushteve, si: zbatimin e reformës zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale; sigurimin në vazhdimësi të zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias; përfundimin e ngritjes së strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; forcimin më tej të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe përmes planveprimit për të adresuar rekomandimet e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF), si dhe amendimin e ligjit të medias sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

12. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

13. Angazhohet të forcojë ndërveprimin dhe veprimtarinë diplomatike me parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në funksion të njohjes më të mirë të zbatimit të reformave nga ana e vendeve anëtare dhe opinionit të tyre publik.

14. Angazhohet të vazhdojë të shqyrtojë me përparësi dhe në një proces të gjerë konsultimi kuadrin ligjor, që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me Kushtetutën dhe konventat ndërkombëtare.

15. U bën thirrje shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe të gjithë aktorëve shoqërorë të përfshihen në mënyrë përbajtjesore në diskutimet e Këshillit Kombëtar të Integrimin Evropian dhe në platformat e tjera, në funksion të mirinformimit për këtë proces me përparësi madhore në interes të vendit.

16. Mbi bazën e arritjeve në zbatimin e përparësive kyçe të Planit të Veprimit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë inkurajon Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij në marrjen e vendimit për mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare sa më shpejt, brenda vitit 2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.9.2020.

DEKRET
Nr. 11743, datë 24.9.2020

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, germa “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nuriye Haxhi Qenaj (Dura)
2. Krenare Mahir Merxha
3. Kanita Murat Nimani
4. Sodiq Ololade Dauda Atanda
5. Natalia (Natalja) Gennadij Ryabova (Rjabova)



6. Gyltene Gafurr Leko (Gashi)
7. Salah Mohamed Saleh Abdou
8. Nurten Mehmet Laci (Sadiku)
9. Ardian Islam Minc (Minci)
10. Mithat Shefqet Broqi
11. Lorik Skënder Sylejmani
12. Qamil Lush Agaj
13. Antigone Latif Prenga (Hasani)
14. Virgilio Angelo Giuseppe Castoldi
15. Marjan Prend Skeli
16. Massimiliano Donino Borelli
17. Hasan Memiş Soyulu
18. Muhammet Cemil Zilifli
19. Cihangir Ökkaş Adanali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 525, datë 18.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 2365, DATË 26.11.2008
“MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 277,
DATË 18.6.1997 ‘PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBRIT’, I
NDRYSHUAR”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar dhe pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pikat 2/1 dhe 2.2 të udhëzimit, ndryshojnë si më poshtë:

“2.1. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor e dërgon atë brenda 24 orëve, me procesverbal/postë pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Mjeku i Shërbimit Social Shtetëror verifikon dosjet e paraqitura për vlerësim nëse janë të plotësuar me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMPV. Personi që vlerësohet për herë të parë, përveç vlerësimit të dosjes paraqitet edhe personalisht para KMPV-së të nivelit të parë.

2.2. Rivlerësimi bëhet bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, pa praninë fizike të individit. KMPV-ja në rastet kur nuk mund të marrë vendim vetëm bazuar në dokumentacionin e paraqitur për rivlerësim, ka të drejtë të thërrasë për t’u paraqitur fizikisht individin në komision. Paraqitja në KMPV do të bëhet në një nga mbledhjet e muajit pasardhës, por jo më vonë se 30 ditë nga data që do të realizohej vlerësimi me dosje. Njoftimi formal për paraqitje në KMPV do të bëhet përmes administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e të cilit ka vendbanimin personi.”

2. Pika 16 e udhëzimit, paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

“Dokumentacioni i dosjes së përfituesit që është vlerësuar nga KMPV-ja, hidhet në arkivin elektronike brenda afateve dhe sipas rregullave të detajuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe më pas dërgohet pranë njësisë administrative së bashku me njoftimin për vendimin për çdo person.”

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, institucionet shëndetësore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Bardhylka Kospiri



URDHËR

Nr. 189/1, datë 22.9.2020

**PËR KORRIGJIMIN E GABIMEVE
MATERIALE NË URDHËRIN NR. 189,
DATË 22.6.2020, TË MINISTRIT TË
DREJTËSISË, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR KONSTITUIMIN,
ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT DISIPLINOR TË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË
PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 73, pika 13, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, si dhe të nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative ,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 189, datë 22.6.2020, të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, korrigjohen gabimet materiale si më poshtë:

1. Togfjalëshi “*neni 6*” zëvendësohet me togfjalëshin “*neni 5*” dhe vijon renditja numerike e neneve në vazhdim të urdhrin.

2. Në nenin 9, pika 2, togfjalëshi “*të nenit 10*” zëvendësohet me togfjalëshin “*të nenit 9*” dhe në pikën 3, germa “d”, togfjalëshi “*sipas germës “ç”, të pikës 2*” zëvendësohet me togfjalëshin “*sipas shkronjës “ç”, të pikës 3*”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë